**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 10, datë 31.01.2019**

**PËR**
**MIRATIMIN E LICENCËS PËR USHTRIM VEPRIMTARIE BROKERIMI NË SIGURIME TË JO-JETËS TË SHOQËRISË SË BROKERIMIT "ASIGEST BROKER ALBANIA"SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, dhe të nenit 204 dhe 211, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", si dhe të Rregullores nr. 48, datë 30.06.2015 "Për kriteret, procedurat dhe afatet e licencimit si dhe rastet e refuzimit të licencës për të ushtruar veprimtari brokerimi në sigurime", me propozim të Departamentit të Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Licencimin e shoqërisë "Asigest Broker Albania" sh.a., për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jo-Jetës, për një periudhë pa afat.

2. Brokeri fizik i shoqërisë është z. Albano Troka, i licencuar nga Autoriteti për ushtrimin e veprimtarisë së brokerimit në sigurime për klasat e Jo-Jetës.

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes së Tregut të Sigurimeve për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR** **DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV**

**Pajtim MELANI** **Ervin KOÇI**